



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1116/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Afrim Shamolli kandidat për anëtar të Asamble Komunale nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Lipjan, paraqitur kundër Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e parregullt ankesa e Afrim Shamolli kandidat për anëtar të Asamblesë Komunale në Lipjan nga radhët e Subjektit Politik PDK.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 04.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Afrim Shamolli kandidat për anëtar të Asamble Komunale nga radhët e Subjektit Politik PDK në Lipjan, i cili pretendon që të verifikohet procesi i numërimit në këto Qendra të Vendvotimeve, QV-2728B/01Q, QV-2710B/02R, 03R, 2711B/01R, 02R, QV-2702B/03R si dhe dëshmitar ka Egzon Gecin.

PZAP-i pasi që shqyrtoi rregullsinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e parregullt

Nga shkresat e lëndës PZAP-i, konstatoi se ankesa është e parregullt për faktin se nuk i përmbush kushtet e parapara në bazë të nenit 3.6 pika d) të rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e ku thuhet se të gjitha ankesat duhet të kenë së paku informacionet vijuese, vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës, andaj për këtë arsye duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr.1116/2013 më datën 06.12.2013

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.